



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

KONTRATË PËR PUNË

KOMUNA E ISTOGUT në vazhdim "Njësia e Prokurimit", të cilën e përfaqëson znj. Zizë Bufupaj, menaxhere e Prokurimit, Rruga "Fadil Ferati" Nr. 121 në njërën anë;

Dhe

"BENITA COMPANY" SHPK nga Klina, të cilën e përfaqëson z. Nexhat Kalludra, me Nr. Rexh. Biznesi, 70035478 (në vazhdim "Kontraktuesit"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

TITULLI I KONTRATËS:

RREGULLIMI I RRUGËS "24 QERSHORI" GURRAKOC – KOMUNA E ISTOGUT LOT 4

Nr. I prokurimit	633-18-5154-5-2-1/C134
Nr. I brendshëm	633 / 018 / 047 / 521

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

RREGULLIMI I RRUGËS "24 QERSHORI" GURRAKOC – KOMUNA E ISTOGUT LOT 4

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve për aktivitetin e prokurimit RREGULLIMI I RRUGËS “24 QERSHORI” GURRAKOC – KOMUNA E ISTOGUT
LOT 4 është: 35.889,50 dhe me fjalë
Tridhjetepesë mijë tetëqindetëntë dhjetë euro 50/100 €

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit të kontratës.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

*Marrëveshja e kontratës;
Kushtet e Veçanta të Kontratës;
Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet
Teknike;
Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
Plani për menaxhimin e kontratës.
Procesverbalet e Vizitës në teren e mbikqyresi*

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dëgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit të emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për



pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftim", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:

Për Kontraktuesin:

Emri:	Zizë Bujupaj	Emri:	"Benita Company Nexhat Kalludra
Pozita:	Zyrtar Përgjigjës i Prokurimit	Pozita:	D r e j t o r
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	04.10.2018	Data:	03.10.2018
Vu la		Vu la	